

**Projekte rrjedhëse të financuara nga Banka Kreditore për Rindërtim – KfW
janar 2022**

Emri i projektit	Përshkrim	Vlera në milionë euro	Viti përfundimtar i marrëveshjes
	Uji dhe mjedisi jetësor		
Ujësullësi dhe kanalizimi i komunave faza 1, hapi 2	Ky projekt synon sigurimin e mjeteve për financimin e investimeve në infrastrukturën e ujësullësit në komunën e Gostivarit. Mjetet grant nga SECO në vlerë prej 4.85 milionë eurove menaxhohen nga KfW për financimin e masave të investimeve sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm dhe përkrahjes së ekspertëve për realizimin e këtij projekti. Shfrytëzuese: komuna e Gostivarit	4,85	2018
Ujësullësi dhe kanalizimi i komunave faza 2 (mjete grant)	Projekti ka për qëllim që të sigurohen mjete për financimin e investimeve në infrastrukturën e ujësullësit në komunat e Gjevgjeliçës dhe Kavadarit. Shfrytëzuese: komunat	5	2017
Programi i ujitjes në Maqedoninë e Veriut	Me këtë Program përfshihet rehabilitimi dhe zgjerimi i 4 sistemeve të ujitjes përgjatë luginës së lumit Vardar (Straitshtë, Lisiçe, Konjsko dhe Pepelishtë), si dhe ndërtimi i hidrocentraleve të vogla të HS Lisiçe. Shfrytëzuese: MBPEU	80	2019
	Energjetikë		
Ngrohja e Manastirit	Me këtë projekt planifikohet zëvendësimi i shfrytëzimit të energjisë elektrike, naftës dhe drunjeve për ngrohje, ku si rezultat do të ulen emetimet e gazrave serrë dhe do të përmirësohet siguria e rrjetit distributiv. Shfrytëzuese: SHA ELEM	39	2015
Parku i turbinave me erë Bogdancë faza 2	Në kuadër të fazës së dytë të këtij projekti, parashihet vendosja e 6 turbinave me erë në parkun Bogdancë, me fuqi të instaluar prej 13.8 MW. Në këtë mënyrë, do të shfrytëzohet era si burim i energjisë së ripërtëritshme përmes ndërtimit të parkut të turbinave me erë, me qëllim që të mundësohet prodhim vjetor shtesë prej 37GWh të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Shfrytëzuese: SHA ELEM	18	2018
Rehabilitimi efikas energjetik i konvikteve të studentëve në RMV	Me këtë projekt përveç masave të efikasitetit energjetik të konvikteve të studentëve, përfshihen edhe masat për rikonstruimin e konvikteve për studentët në përgjithësi, me qëllim që të përmirësohen kushtet për qëndrimin e studentëve. Shfrytëzuese: MASH	20	2019